

ARADHA PARTIZANE »ZEJNEL HAJDINI«

»Të formohen aradhat partizane, në radhë të parë aradhat partizane shqiptare, e më vonë të kombinohen, të cilat jo vetëm me agjitacion, por edhe me aksione do t'ua tregojnë në praktikë masave si duhet luftuar...¹ ishte një nga detyrat që Komiteti krahnor i PKJ të Kosovë e Metohisë shtroi në Konsultën e mbajtur në shkurt të vitit 1942 në fshatin Vitomiricë afër Pejës.

Ndonëse kushtet ishin shumë të vështira për zhvillimin e Luftës nacionalçlirimtare në Kosovë e Metohi, prapëseprapë u krijuan mundësitë që të mposhten kushtet dhe që të zhvillohet me sukses Lëvizja nacionalçlirimtare. Formohen komitete të reja të vendit të PKJ, organizata e punkte të reja të partisë, u zgjërua dhe u forcua puna e LRKJ, u forcua puna politike ndër masa, u formuan këshillat nacionalçlirimtar, të cilët kanë luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin e vëllazërimit dhe të bashkimit, në përvetësimin e masave, në mbledhjen e ndihmave në ushqim, armë e veshmbathje për partizanë. U forcua puna në mesin e femrave, u formuan njësitë ushtarake të prapavisë, të cilat nën udhëheqjen e partisë zhvilluan aksione të ndryshme — organizonin mbrojtjen e fshatrave nga sulmet e tradhëtarëve, rrënonin ura, likuidonin spiunë, kputnin telat e telefonit dhe prenin shtylla, bënë sabotime nëpër miniera, spitale, rrugë dhe në vende të tjera.

Gjatë vitit 1942 rolin agjituës dhe edukativ e luajnë gazetat »Zani i popullit«, më vonë »Zani«, organ i Frontit të unjësuar nacionalçlirimtar të Kosovës e Metohisë, »Liria« fletushkë popullore antifashiste e Prizrenit, »Kroz borbu« organ i Frontit çlirimtar të Prishtinës, rol të rëndësishëm luajti edhe artikulli »Çështja nacionale në Jugosllavi në aspektin e LNC«, i cili nga »Proleterit« nr. 16 (organ i KQ të PKJ) u përkthye dhe u shumëzua në gjuhën shqipe, por që shumëzuar edhe në gjuhën sërbo-kroate. Në atë kohë u përkthyen dhe u rishtypën disa kaptina nga historia e PKS (b) dhe çështja e leninizmit. Në prag të një majit në Gjakovë u rishtyp Proklamata e KQ të PKJ me rastin e një majit dhe u shpall proklamata e KV të Gjakovës. Në atë periudhë shtypen dhe shpërndahen laj-

¹ AEHK, Rezoluta nga Këshillimi i frorit të KK PKJ për Kosovë e Metohi 1942, dt. 96

met e ditës në gjuhën shqipe e sërbo-kroate, u formuan qendrat teknike në të gjitha komunat e mëdha. Më 28 nëndor u organizuan demonstrata antifashiste në të cilat u hüdhen parulla kundër pushtuesit dhe bashkëpunëtorëve të tij, parulla të vëllazërimit dhe të bashkimit etj. Demonstratat e forcuan edhe më shumë frymën, entuziasmin luftarak të masave, i mobilizuan në luftë kundër pushtuesit dhe tradhëtarëve të vendit. Por pushtuesi dhe trathtarët, duke vërejtur aktivitetin e komunistëve, e shtuan edhe më shumë terrorin mbi popull dhe zunë t'i ndiqnin pa mëshirë, mizorisht komunistët dhe ithtarët e LNÇ, kurse reaksioni luftonte me të gjitha forcat për t'i penguar dhe asgjësuar krijimin e bashkimit të popullit.

Në letrën e KQ të PKJ dërguar KK të PKJ të Kosovë e Metohisë me rastin e Konsultës së shkurtit për reaksion shkruan sa vijon: »Poashtu nuk keni vërejtur faktin se në Kosovë e Metohi ekzistojnë dy klika të ndryshme, të kundërta të kolonës së pestë. Njëra është klika sërbo-madhe, e cila gjatë muajve të parë të pushtimit ishin pasivizuar nën presion, e në kohë të fundit vjen gjithnjë e më tepër në shprehje si instrument i pushtuesit në luftë kundër aspiratave të masave shqiptare që të ngrihen dhe kundërshtojnë haptazi plaçkitjen e pamshirëshme dhe të pakufijshme të banditëve të pushtuesit. Ajo klikë e kolonës së pestë është fajtores kryesore që masat shqiptare u ngritën kundër kolonistëve, gjegjësisht sërbeve e malazezëve. Klika tjetër e kolonës së pestë është klika proshqiptare, gjegjësisht ajo e cila në radhë të parë i shërben pushtuesit, me ndihmën e të cilit shpreson dhe përpiqet të ruajë formën feudale të nënshtrimit dhe eksploatimit të fshatarëve të varfër në Kosovë e Metohi.«²

Prej konsultës së shkurtit dhe asaj të korrikut pason rritja dhe forcimi i organizatave të partisë dhe një zhvillim edhe më i fortë i lëvizjes nacionalçlirimtare.

Komiteti krahinor në konsultën e vet të korrikut në fshatin Gërbolë afër Ferizait, duke analizuar situatën politike dhe punën e komunistëve në Kosovë e Metohi, konstaton se nëpër organizatat e partisë mbizotëron uniteti, bashkimi i duhur i plotë, gjë që kush-tëzon që puna e tyre të jetë edhe më e fortë dhe më intensive dhe të jetojnë në frymën dhe jetën e partisë, ndonëse kanë edhe një seri gabimesh e të metash në punën partiake.

Konsulta e korrikut u shtroi Komitetit krahinor të PKJ për Kosovë e Metohi dhe organizatave partiake e anëtarëve të partisë detyra: të udhëhiqen masat e gjëra popullore në luftë kundër pushtuesit dhe bashkëpunëtorëve të vendit, të depërtohet në vendet ku s'ka organizata të partisë, të edukohen kuadro të reja, të forcohet syceltësia ndaj elementeve antipartiakë, të udhëhiqet rinia në luftë kundër pushtuesit, të formohen këshillat e grave, të forcohet puna agjituese-propagantistike, të aftësohet teknika, të bëhen përgatitjet e duhura dhe të formohen aradhat e armatosura partizane.

Viti 1942 ishte vit i rritjes, zgjerimit të LNÇ në shumë fshatra e qytete. Në fund të atij viti dhe në fillim të vitit 1943 armiku pa-

² AEHK, Letra KQ PKJ dërguar Komitetit krahinor PKJ për Kosovë e Metohi, d. 17439.

raçitet më intensivisht në skenë, pasojnë arrestimet, pushkatimet. Partia pësoi humbje të mëdha. Por anëtarët e partisë as në ato ditë të vështira nuk pushuan së punuari.

Meqë gjer në Konsultën e korrikut të vitit 1942 nuk u formuan aradha të armatosura partizane, në këtë Konsultë u vendos të formohet një aradhë partizane, e cila nuk do t'i jipte grusht vetëm pushtuesit, por ndër masat shqiptare do të popullarizonte Luftën nacionalçlirimtare. Në rezolutën e miratuar në Konsultë thuhet:

»Në pikëpamje të punës në lëmën ushtarake, detyrë kryesore që shtrohet tani është përgatitja dhe formimi i aradhave të armatosura partizane. Duhet vazhduar edhe më intensivisht se gjertani përgatitjen ushtarake dhe politike të njerëzve. Duhet depërtuar në radhët e shqiptarëve dhe të përfshihen nëpër aradha. Organizimi i shërbimit të mirë informativ është edhe një nga detyrat imperative. Kudo duhet organizuar formimin e komandave. Të bëhet koordinimi i punës mes partisë e komandave, të cilat do t'i sigurojnë partisë udhëheqje të sigurt në tërë këtë veprimtari.«³

Pas Konsultës së korrikut në fund të tetorit të vitit 1942 për hir të organizimit më të mirë të njëjseve ushtarake, u formua Shtabi i përkohshëm ushtarak për Kosovë e Metohi. Komandant i këtij Shtabi ishte Fadil Hoxha, komisar — Boris Vukmirovic, kurse këshilltar ushtarak Petar Brajevic. Shtabi i përkohshëm ushtarak kishte për detyrë të organizonte njësitë ushtarake të prapavisë nëpër fshatra dhe të përgatiste formimin e një aradhe partizane, detyra e së cilës do të ishte të manovronte në territorin e Kosovës dhe Metohisë, të ndërmarrë e zhvillojë aksione dhe ta përgatisë popullin për luftë kundër pushtuesit.

Pas përgatitjeve të bëra për formimin e aradhës, sigurimit të njerëzve për aradhë, përgatitjes së terrenit për manovrimin e aradhës, përgatitjes së bazave të armëve, kuadrit komandues, të formohet aradha e armatosur.

Luftëtarët e aradhës filluan të tuboheshin në fshatrat rreth e përçark Ferizajit dhe Gilanit.

Në Gërbolë me në krye Fadil Hoxhën u tuban pikë së pari këta luftëtarë: Nexhmedin Nixha, Mazllum Këpuska, Idriz Bytyçi dhe Nijazi Spahi. Ky grup partizanësh bashkë me Fadil Hoxhën erdhën në fshatin Softoviq dhe u vendosën në shtëpi të Aleksa Vuçeniqit, ku i pritit sekretari i KK të PKJ Boris Vukmirovic — Cërnj. Aty u takuan me partizanët Tafë Sejdi Kamogllavën, Asllan Biqevcin dhe Petar Karaxhiqi. Ky grup partizanësh nisët në kushte shumë të vështira nga fshati Softoviq për në fshatin Ramlan me qëllim që të vejë kontakt me partizanët Xheladin Kurbalija, Kurtesh Agushi, Sinan Hasani, Riza Selim Presheva dhe Rashit Xhaferi nga Shkupi. Pasi u takuan këta partizanë, u formua aradha.

Aradha u formua natën në mes 27 e 28 shtator 1942 afër fshatit Ramlan, në afërsi të mullirit, i cili ndodhej buzë rrugës mes Ferizajt e Gilanit.

Komandant i aradhës u zgjodh Xheladin Kurbalija, punëtor nga Pomaravla e Gilanit, zëvendës i komandantit Pera Karaxhiqi

³ AEHK, Rezoluta nga Këshillimi i korrikut 1942 të KK, dt. 106.

»Muja« nga Prishtina, komisar Fadil Hoxha, mësues nga Gjakova, zëvendës i komisarit Kurtesh Agushi nga Gilani dhe intendant Njazi Spahiu nga Luma (Shqipëri).

Lidhur me formimin e aradhës dhe pregatitjet e partizanëve u angazhuan posaçërisht Boro Vukmirovic, Pavle Joviqevic dhe Fadil Hoxha.

Aradha me rastin e formimit kishte 13 luftëtarë dhe u quajt »Zejnel Hajdini« sipas emrit të luftëtarit të shquar shqiptar nga territori i Jabllanicës, i cili u vra në Gazdinski rid më 7 mars 1942 në luftë kundër çetnikëve, gjermanëve dhe bullgarëve.

Aradha u formua në kushte shumë të vështira. Luftëtarët e rinj ishin pa përvojë ushtarake, të veshur dhe të armatosur dobët (kishin tri pushkë, një mitroloz »Bërno« dhe një revole), ndërsa presioni i armikut ishte shumë i fortë.

Duke folur për disponimin luftarak të luftëtarëve dhe për vështirësitë në të cilat haste aradha në lëvizjet e veta për shkak të situatës së vështirë politike, Fadil Hoxha, komisar i aradhës, u shkruante shokëve të Komitetit krahinor: »Në rast se aradha arrin të qëndrojë një muaj, atëherë do të qëndrojmë gjer në çlirimin definitiv të vendit.«⁴

Për formimin e aradhës »Zejnel Hajdini« u dëgjua shpejt anemane Kosovës dhe Metohisë, sepse në aksionet e veta kundër pushtuesit ushtronte ndikim të parreshtur dhe i nxiste masat, sidomos ato shqiptare, për rezistencë kundër pushtuesit fashist.

Formimi i aradhës — shumica shqiptarë — ushtroi ndikim të madh jo vetëm ke populli shqiptar, por edhe ke populli sërb, sepse ndër masat sërbe u formua bindja se edhe shqiptarët po luftojnë kundër pushtuesit.

Baza kryesore të aradhës në fillim ishin fshatrat Sojevë, Tankosiq, Gërbolë, Softoviq, Staro Sello, Biba, Vrella, Staro Gracko, etj.

Duke ndërruar ditë për ditë terrenin e qëndrimit dhe duke punuar politikisht me fshatarë, aradha e zgjeroi ndikimin e vet dhe krijoi baza edhe në fshatrat më të largëta, siç janë: Kishno Pole, Sllakovc, Zllatar, Tërpezë, Zhegovc, Ponesh, Malishevë etj.

Duke operuar në shumë fshatra — Zllatar, Sllakovc dhe mes tyre në drejtim të pjesëve jugore të bjeshkës së Zhegovcit, bazë e aradhës në Zllatar natën ishte shtëpia e Topallit, kurse në Jerli Sllakovc, shtëpia e Hashimit. Aradha ditën rrinte në malin e afërm, kurse ushqim merrte prej anëtarëve të partisë nga fshati Tankosiq. Përveç detyrave politike, aradha bëri edhe aksione të vogla diverzante. Duke ndërruar terrenin e qëndrimit, rrugës prenin shtylla dhe këputnin tela telefoni.

Luftëtarët e kësaj aradhe ndonëse e dinin mirëfilli se kushtet për luftë të armatosur në Kosovë e Metohi janë shumë të vështira, ishin të gatshëm edhe për sakrifica, sepse e dinin se s'ka fitore pa luftë. Duke manovruar nëpër këto fshatra, aradha zu të rritet dita më ditë. Aradhës iu bashkuan Faik Xhema Kashtanjeva, Ejup Terpeza dhe Stanijan Dimitrijeviq — Shefqeti nga Terpeza, Dimitrije

⁴ AEHK, Stenogrami nr. 74, f. 30.

Stojkoviçi nga Novo Sella. Me ardhjen e luftëtarëve të ri, duke i bërë fshatarët për vete dhe duke kryer aksione të ndryshme, aradha siguroi edhe armë të reja.

Në saje të shtimit të numrit të luftëtarëve dhe të shtimit të armëve, do të thotë forcimit të armatimit, kjo aradhë bashkë me aradhën e Vranjës i rroket një aksioni më të madh dhe sulmon minierën Llojana.

Aradha nacionalçlirimtare e Vranjës »Simo Pogaçareviç«, e cila u formua më 18. IX. 1942, komandant i së cilës ishte Zhivojin Nikoliq — Bërko, komisar politik Dushan Devergjiq — Zhika, zëvendës i komandantit Vllada Tasiq — Boshnjak dhe zëvendës i komisarit politik Sllobodan Cekiq — Radovan muar për detyrë nga Komiteti i qarkut i PKJ të Leskovcit që të lidhet me Lëvizjen nacionalçlirimtare në terrenin e Malit të Zi të Shkupit dhe të vejë kontakte me organizatën e Partisë në terrenin në jug të Vranjës.

»Aradha e Vranjës qëndroi një kohë në fshatrat: Stajkovc, Nesvërt, Slivnicë, Përvonek, Brezovicë, Sveti Ilija dhe mbajti konferenca me popull. Kjo aradhë ishte e përcjellë dhe e ndjekur vazhdimisht prej forcave të vogla të ushtrisë dhe policisë së pushtesit, por i shkoi përdore të kapërcente Moravën jugore afër fshatit Ribnica dhe të kalojë mbi Vranjë në vendin e ashtuquajtur Sarajska Kuqa. Pas qëndrimit disa ditësh në këtë vend në konspiracionin më të madh, aradha kaloi në terrenin e Kurbalisë, në afërsi të fshatit shqiptar Vërban. Aty logoroi, e në mbrëmje erdhi në fshat. Me të ardhur në fshat, aradha mbajti një konferencë me popullsinë e vendit në të cilën populli u informua për qëllimin e Lëvizjes nacionalçlirimtare. Në mëngjes në orën 4 aradha braktisi fshatin dhe u kthye përsëri në logorim në vendin Peka në afërsi të fshatit. Brenda po asaj dite aradha u bllokua dhe u sulmua nga forcat bullgare pasi qe tradhëtuar.«⁵

Aradha u thye edhe për shkak të syçeltësisë së dobët të partizanëve dhe për shkak të zgjedhjes së vendit të papërshtatshëm për logorim. Aradha pësoi humbje të mëdha. Ajo u thye dhe u nda në grupe. Një pjesë e madhe e aradhës me shtab jo të plotë, nën presionin e çetnikëve dhe të fashistëve bullgarë zu të depërtojë në drejtim të fshatrave të Karadakut të Shqipërisë, duke kërkuar baza të reja për strehim.

Në fshatin Kurbalija nëpërmjet të vëllait të Xheladin Kurballiut, Ymerit, arrijti të vejë lidhje me organizatën e partisë në Preshevë, kurse me anë të Selim Selimit dhe Abdullah Aliut, një grup partizanësh të aradhës së Vranjës bie në kontakt me komisarin e aradhës »Zejnel Hajdini«, Fadil Hoxhën. Posa u informua mbi gjendjen e aradhës së Vranjës, Fadil Hoxha i jep urdhër aradhës »Zejnel Hajdini« që të kalojë në territorin e pushtuar nga fashistët bullgarë dhe të vejë kontakt me grupin e partizanëve të aradhës së Vranjës »Simo Pogaçareviç«. Megjithse fashistët bullgarë e ruanin kufirin me forca të mëdha, aradhës »Zejnel Hajdini« i shkoi përdore të kalojë në territorin nën fashistët bullgarë dhe të takohet me grupin e partizanëve të aradhës së Vranjës. Në atë grup

⁵ M. Mihioviq, *Aradha e Vranjës »Sima Pogaçareviç«,* Separat i posaçëm nga »Vranjski glasnik«, f. 30.

ishin 17 partizanë. Menjëherë, posa u takuan të dy aradhat, e me vendimin e shtabeve të të dy brigadave, u formua një aradhë e përbashkët partizane, pa emër, me shtab të përbashkët. Komandant i kësaj aradhe të përbashkët ishte Zhivojin Nikoliq — Bërka, zëvendës i komandantit Xheladin Myftari Kurbalija, komisar politik Fadil Hoxha, zëvendës i komisarit politik Sllobodan Cekiç — Radovan dhe intendant Nijazi Spahiu.

Kur u formua brigada e përbashkët, situata si në Sërbinë jugore, ashtu edhe në Maqedoni, ishte shumë e vështirë. U shfaq një reaksion i madh. Çetnikët dhe fashistët bullgarë gëzoheshin.

Për t'i treguar këtij reaksioni se ekzistojnë edhe forcat partizane, të cilat luftojnë kundër reaksionit e fashistëve dhe të cilat janë në gjendje t'i japin grusht të fortë armikut, partizanët e të dy aradhave me komandë të përbashkët vendosën ta sulmonin minierën e kromit Lojane, e cila ndodhet disa kilometra larg Kumanovës, në shtatitë veriore të Karadakut. Minierën e eksploatonin pushtuesit gjermanë dhe bullgarë. Xehet e eksploatuara nga kjo minierë dërgoheshin në Gjermani, sepse i ishin të domosdoshme industrisë ushtarake gjermane. Aradha në prak të sulmit në minierë që vendosur në shtëpi të Mehmet Llozanës në Kuscë të Poshtëm, ku u furnizua me ushqim e municion.

Pas përgatitjeve të bëra u sulmua miniera. Aksioni pat sukses. Ai ishte aksioni i parë i përbashkët i aradhës »Zejnel Hajdini« dhe aradhës partizane të Vranjës »Sima Pogaçareviq«. Grupi i partizanëve depërtoi në minierë natën, ndërsa një grup tjetër kishte për detyrë ta rrethonte minierën dhe të likuidonte rojën. Rojet sapo diktuan se partizanët po i afroreshin minierës, hapën zjarr dhe e braktisën minierën, gjegjësisht tretën në errësi. Drejtori dhe mbarrë drejtorja e minierës u zunë robë. Miniera u çaftësua për një kohë të shkurtër dhe u zhdukën planet e minierës dhe të instalimit elektrik, u konfiskuan të hollat, u bart i tërë ushqimi dhe materiali eksploziv që ndodhej në depo të minierës.

Pas kryerjes së aksionit Fadil Hoxha u foli punëtorëve të minierës për rëndësinë e Luftës nacionalçlirimtare dhe për qëllimin e aksionit në minierë. Pas fjalimit u tha punëtorëve se të gjithë mund të marrin e të çojnë nëpër shtëpitë e tyre nga një thes miell e një thes sheqer. Shumica e fshatarëve u luhatën në fillim, por pasi ra musgu i parë, filluan një nga një të bartin ushqim nëpër shtëpi të tyre.

Në dokumentin e Shtabit të përkohshëm të Lëvizjes nacionalçlirimtare dhe të Ushtrisë vullnetare të Jugosllavisë për Kosovë e Metohi të 1 nëndorit 1942 për aksionin në minierën Lojane shkruan si vijon:

»Këto ditë aradha partizane shqiptare »Zejnel Hajdini« sulmoi minierën Lojane. Me atë rast u dogjën të gjitha planet e minierës dhe u mbajtë tubimi i të gjithë punëtorëve, ku u paraqit situata politike dhe u fol për rëndësinë e luftës partizane.

Me rastin e zhvillimit të aksionit u zunë dhe u konfiskuan më se 10 mijë kilogram miell e 1.000 kilogram sheqer, të cilat iu ndanë menjëherë punëtorëve. Në atë aksion partizanët konfiskuan edhe 15 batani, 50 kilogram sapun, një shalë, dy samarë, 100 kilogram

dinamit, 200 shtapion, 4 pushkë me 100 fyshekë, një revole me 25 fyshekë, një shaptilograf, letër, thasë, mbulesa dhe një milion e diçka leva».⁶

Fletushka e Lëvizjes nacionalçlirimtare të Maqedonisë »Oktoberis« më 21 tetor 1942 boton një informatë për aksionin e përbashkët të partizanëve të Vranjës dhe të Kosovës në minierën Lojane dhe shkruan: »Ky sulm i suksesshëm i partizanëve të unjësuar serbë, maqedonë (në aradhën e Vranjës ishte edhe Karposh dhe disa maqedonë) dhe shqiptarë është argumenti më i mirë se janë vënë temelet e bashkimit të popujve dhe se dita më ditë po bëhet gjithnjë e më i fortë.«⁷

Pas aksionit në minierën Lojane, aradha me kuaj të minierës të ngarkuar me miell e artikuj të tjerë dhe dinamit, duke udhëtuar gjithë natën në mot të ftohët, arriti në maje të Kopilaçes (në Karadak). Në Kopilaç aradha e kaloi ditën e pushoi, e pastaj përsëri u nis natën dhe arriti në fshatrat Tërpezë e Tankosiq.

Aksioni në minierën Lojane ka rëndësi të madhe, sepse mu para syve të pushtuesit, buzë rrugës aq të rëndësishme — hekurudhës Beograd — Shkup në afërsi të Kumanovës, u asgjësua me sukses miniera e metalit aq të rëndësishëm, i cili shërbente për nevoja të armatimit luftarak të Gjermanisë.

Aksioni u zhvillua në kohën kur fashistët në të gjitha frontet qëndronin akoma relativisht mirë, kur as në Sërbi, as në Maqedoni e as në Kosovë nuk qe zhvilluar akoma ndonjë aksion i këtille serioz.

Aksioni kishte rëndësi të madhe, sepse — për partizanët të cilët e zhvilluan — ishte inkurajim i madh dhe i ushqeu me vetëbesim dhe u dha fuqi edhe për aksione të tjera. Shihej qartë që nëse aksioni organizohet mirë, është e mundur që me pak forca të ketë sukses edhe ndonjë aksion i rëndësishëm.

Gjatë kthimit aradha preu shtyllat e telefonit prej Popovci gjer në Livoç të Poshtëm. Pushtuesi mendonte se aksionin e prerjes së shtyllave po e zhvillojnë antifashistët nga Gilani, prandaj kërkonte listën e komunistëve në Gilan.

Shtabi i aradhës menjëherë iu përvesh zbatimit të një aksioni tjetër të rëndësishëm — që me dinamit të cilin e kishte konfiskuar në minierën Lojane ta rrëzojë urën dhe ta çojë në ajër hekurudhën në grykë të Kaçanikut dhe ta çaftësojë këtë relacion të rëndësishëm të komunikimit për pushtuesin Selanik — Evropa Qendrore.

Pushtuesi, i vetëdijshëm se çfarë domethënje e rëndësie kanë ato rrugë e hekurudha, me forca të forta e bunkerë i ruante urat e tunelet në grykë të Kaçanikut. Aradha ndonëse tri ditë e tri netë qarkulloi nëpër shkrepat e grykës së Kaçanikut nuk arrijti ta rrëzojë urën e ta rrënojë tunelin, sepse e ruanin forca të forta të armatosura fashiste bullgare.

Si gjatë përgatitjeve për kryerjen e aksionit në minierën Lojane ashtu edhe gjatë përgatitjeve dhe përpjekjeve që të shkatërrohet, çohet në ajër hekurudha në grykë të Kaçanikut, në aradhë

⁶ AEHK, SHK, dt. 2.

⁷ Përmbledhja e dokumentave dhe shënimeve nga LNÇ e popujve të Jugosllavisë, vëllimi VII, libri I, f. 141.

s'ishte asnjë partizan, i cili e njihte terrenin dhe i cili do të bënte të mundur që partizanët të lëvizin më lehtë dhe më të sigurtë. Për shkak të mosnjohjes së terrenit dhe pasigurisë, për shkak të mungesës së ushqimit, sepse aradha mbahej në ilegalitet rigoroz, për shkak të ditëve të ftohta dhe veshjes së dobët të partizanëve, nga frika prej hakmarrjes së ushtrisë fashiste bullgare, e nga ana tjetër edhe për shkak të mungesës së vendosmërisë dhe qëndrueshmërisë së Xheladin Kurbaliut dhe disa partizanëve të tjerë u shfaq njëfarë demoralizimi, kështuqë në fillim zunë të flitnin në mes të tyre me shokët më intimë, e më vonë edhe më haptazi se nuk ekzistojnë kushtet për ekzistencën e aradhës dhe se aradha duhet të shpërndahet, nga se duhet pritur kushte dhe ditë më të mira.

Në atë kohë aradha e Vranjës po përgatitej të kthehej në Sërbi me komandantin Zhivojin Nikoliq dhe komisarin Zhika Deverxhiq. Aradha që plotësuar me luftëtarë të rinj nga fshati Tankosiq dhe fshatrat e tjera rreth e përçark. Aradha u kthye nëpër Gilan e Vërbanski llogor dhe më 7 nëndor arriti në Përzhan mbi Vranjë.⁸

Pas largimit të aradhës së Vranjës, aradha partizane »Zejnel Hajdini« garkulloi edhe disa ditë nëpër fshatra të Kosovës dhe u prit ngrohët nga fshatarët në fshatin Mirosavle, në shtëpi të Ali Demës në Mirash, në shtëpi të Musli Rashës, Sherif Kadriut, Brahës dhe Nebih Asllanit, në Sazli aradha qëndroi në shtëpi të Tafil Aliut, Ilijaz Aliut, Islam Rexhepit, Lyt Salihut, në Cesars ke Musa Kupa; në Terpezë ke Rexhep Mehmeti; në Kishnople ke Osman Spahiu; në Vrellë ke Radomir Bojaniqi dhe Jovan Parazhanini.

Në aradhën »Zejnel Hajdini« ashpërsohen konfliktet në mes Xheladin Kurbaliut dhe ithtarëve, bashkëpunëtorëve të tij, të cilët përhapnin njëfarë demoralizimi. Thelbi i shëndosh i aradhës ishte i vetëdijshëm se çka do të thotë aradha partizane për Kosovën dhe ai ishte i gatshëm që me gjithë vështirësitë e shumta, të zhvillojë aksione të armatosura dhe të forcohet vazhdimisht. Fadil Hoxha, Mazllum Këpuska, Njazi Spahiu, Idriz Bytyqi, Kurtesh Agushi e të tjerë bënë përpjekje maksimale për ta mbajtur aradhën, në ç'drejtim edhe ia dualën në krye.

Përveç demoralizimit dhe frikës që u përhap nga ana e Xheladin Kurbaliut dhe disa ithtarëve të tij, ata gjatë aksionit në minierën Lojane plaçkitën dhe mëslehën disa gjëra. Partizanët u informuan më vonë për këtë, prandaj e dënuan rreptë një akt të tillë dhe kërkuan që gjësendet e vjedhura t'i kthehen menjëherë shtabit, sepse një gjest i tillë nuk u ka hije partizanëve. Xheladin Kurbaliu u prek për këtë, prandaj u orvat që konfliktin ta shndërrojë në konflikt personal — kinse gjakovarët Njazi Spahiu dhe Kurtesh Agushi e urrejnë, i kanë inat.

Në Komitetin krahinor të PKJ kjo çështje u sqarua dhe Xheladin Kurbaliu u shkarkua nga detyra e komandantit të aradhës. Ai braktisi aradhën bashkë me dy ithtarë, bashkëpunëtorë të tij, të cilët erdhën në aradhë në fshatin Malishevë para Gilanit pak para se të bashkohej ajo me aradhën e Vranjës. Ai shkon në Gilan me

⁸ Si për sh. në 5, f. 32.

premtime se në prapavi do t'i kontribuojë edhe më shumë luftës nacionalçlirimtare, por pas tre muajsh u vu haptazi në shërbim të pushtuesit.

Ndonëse në aradhë u shfaqën demoralizime ke disa individë për shkak të qëndrimit të tillë të Xheladin Kurbaliut dhe bashkë-mendimtarëve të tij, e disa edhe braktisën aradhën, prapëseprapë kjo aradhë luajti rol të rëndësishëm, kështuqë duke qarkulluar nëpër fshatra të Kosovës, aradhës zunë t'i bashkoheshin forca të reja e të shëndosha dhe komunistë të aftë. Në atë kohë në aradhë vjen Meto Bajraktari, Hamzë Krasniqi, Viktor Gulija dhe Dushan Tomoviq.

Aradha »Zejnel Hajdini« e organizuar, e forcuar me luftëtarë të rinj dhe e spastruar nga oportunistët, me direktivën e KK të PKJ nga gjysma e nëndorit të vitit 1942 nisët për Metohi me shtab të ri — me Fadil Hoxhën komandant aradhe me Nijazi Spahiun zëvendës komandanti me Mazllum Këpuskën, kryes i detyrës komisarit politik, dhe zavendës kom. pol. Dushan Tomoviq, Mazllum Këpuska ka qenë njëkohësisht edhe delegat politik i togut.

Aradha me të nisur nga Sojeva për Metohi kalon nëpër fshatrat: Davidovc, Tankosiq, Staro Grackë, Sazli, Vrellë Arilaç, Berishë, Domenik, Kijevë, Zatriq, Kromovik dhe arrin në Gjakovë. Me rastin e arritjes së aradhës në Staro Grackë u mbajt tubimi i banorëve të fshatit. Në atë tubim foli Fadil Hoxha për qëllimet e luftës, e pastaj u shfaq një program i pasur kultural. Në fshatin Vrellë partizanët e aradhës bashkë me banorët e Vrellës dhe të përfaqësuesve nga Fusha e Kosovës, Obiliqit, Suvi Dolit, Radevës, Lugut, Dobrevës e Magurës (afro 200) kremtuan përvjetorin e Revolucionit të Tetorit. Banorëve të tubuar të fshatit për rëndësinë e Revolucionit të Tetorit u folën Apostol Përshendiq dhe Fadil Hoxha. Duke kaluar nëpër këto fshatra, aradha mbajti konferenca me fshatarë dhe zhvilloi bisedime të gjata, i ftoi fshatarët autoritativë nga fshatrat dhe të gjithëve u mbajti fjalime, u ndau afisha, u shpjegoi qëllimet e Luftës nacionalçlirimtare dhe rëndësinë e vëllazërimit dhe të bashkimit të shqiptarëve, sërbeve dhe malazezëve. Aradha u prit shumë mirë në të gjitha këto fshatra — muar ushqim dhe u sigurua strehimi për të gjithë luftëtarët.

Në Vrellë aradha u vendos ke Vukota Mirjaçiq, sekretar i celulës, familje komuniste, e cila gjithmonë i ka pritur ngrohët partizanët dhe është kujdesuar për ta shumë, me mish e shpirt.

Në Berishë aradha qëndroi ke Tahir Berisha, i cili u vu gjithashtu në shërbim të partizanëve.

Lypset përmendur se në këto fshatra ka pasur edhe familje të tjera të cilat i priten duarhapët partizanët. Në Domenik bazë e partizanëve ishte shtëpia e Kadri Minushit.

Duke qarkulluar në këtë terren, aradha vazhdimisht mbante lidhje me Komitetin e vendit të Partisë në Gjakovë dhe në Komitetin Krahinor të PKJ për Kosovë e Metohi. Gjatë qëndrimit të vet në rrethinë të Gjakovës, aradha zhvilloi një aktivitet të madh politik-propagandistik. Organizoi shumë tubime, mbledhje, bisedime,

konferenca ku shpjegoheshin qëllimet e Lëvizjes nacionalçlirimtare, e njëkohësisht preu shtylla telefonike, këpuste tela dhe likuidoi disa spiunë.

Aradha qëndroi një kohë të shkurtër edhe në Gjakovë, sepse ishte ajo një ndër bazat më të sigurta. Në Gjakovë ishin të shumta familjet të cilat i pritnin ballëhapët, ngrohët partizanët, i ushqenin dhe pastronin ndërresat e tyre, e posaçërisht u dalluan familja e Xheladin Hanës, Ymer Pulës (në shtëpi të këtij të fundit bile që vendosur e tërë aradha dhe që siguruar ushqimi, fjetja, pastrimi dhe arnimi i ndërresave, rrobeve dhe këpucëve). Këto punë i kryenin Gjylsha Pula dhe Shirine Brovina. Aradhës i kanë ndihmuar edhe Sabrie Vokshi, Xhije Hana dhe Zymrit Bakia.

Partizanët e kësaj aradhe gjetën strehim edhe në shtëpi të Qamil Zenunit, Ibrahim Muhaxhirit, Selim Hoxhës, të cilët banonin në periferi të Gjakovës dhe ku ishte bukur lehtë për partizanët që të vinin aty. Brenda në qytet baza të partizanëve kanë qenë shtëpitë e familjeve të Abedin Tërbeshit, Taib Bakisë, Sylejman Domet etj.

Aradha zhvilloi një aktivitet të madh edhe në vetë qytetin e Gjakovës. Shtabi i aradhës mbajti takim me një sërë njerëzish autoritativë, kurse Fadil Hoxha u takua me Komitetin e Vendit të PKJ të Gjakovës dhe me Këshillin nacionalçlirimtar.

Në Gjakovë Shtabi i aradhës shpalli proklamata me rastin e 28 nëndorit. Në proklamata, pos tjerash, thuhej: »Fuqitë liridashëse të botës me Rusinë sovjetike në krye po ia japin grushtin e fundit pushtuesve fashistë. Vëllazërit tanë partizanë në Jugosllavi e Shqipëri po bëjnë lufta të rrepta kundër pushtuesve... Edhe ne e kemi filluar luftën e s'është larg dita kur kulshedra fashiste do të shkatërrohet plotësisht...«

Ngrihu burra bashkohuni në çeta partizane. Filloni luftën që të ruani jetën tuaj, familjen tuaj, vendin tuaj... s'ka më neutral, o me lirinë — me ne, o me robërinë — me fashizmin.⁹

Në Gjakovë në atë kohë u shpall edhe proklamata e Komitetit nacionalçlirimtar të Gjakovës në të cilën ftohet populli që të përfshihet në aradhat partizane të Kosovës.

Strehimi i sigurt i aradhës në këto baza të Gjakovës është argument i fuqisë së Lëvizjes nacionalçlirimtare të Gjakovës.

Aradha në Metohi qëndroi në fshatrat Junik, Voksh, Pobergjë, Dobrosh, Sllup, Drenoc, Kodrali, Smoliq, Shishman, Mulliq, Brovinë, Llukë, Deçan, Cara Breg, si dhe në disa fshatra të tjera të komunës së Rrznëqit. Në shumicën e këtyre fshatrave aradha shkoi me kryetarin e komunës së Rrznëqit Rustem Abdullah Qerimin, antifashist i cili i'u bashku më vonë partizanëve dhe u vra në luftë më vitin 1944.

Qëndrimi i aradhës në këtë teren krijoi besim ke njëërëzit dhe u bindën se shqipëtarët e serbët po luftojnë bashkarisht kundër pushtuesit dhe kuislingëve të tij.

Në Gjakovë e rrethinë aradhës iu bashkuan punëtorët e partisë, skojistët të cilët ishin kompromituar, ata të cilët nuk mund të

⁹ Arhivi Qëndror i RP të Shqipërisë, nr. 9, 10, XII. 1942.

qëndronin më ilegalë: Elhami Nimani, Qamil Brovina, Xhavit Brovina, Beqir Ndou, Musa Zajmi, Xheladin Nixha, Gani Çavdarbashi, Dragutin Gjorgjeviq, Metush Grezda, Mazllum Baraku, Faik Pruthi, Pavle Miranoviç nga Ratkoceri dhe Abdullah Shabani nga Mitrovica.

Aradha pasi që kaloi nëpër fshatrat të nahijes së Gjakovës në fund arriti në fshatin Cara Breg. Këtu prej aradhës ndahen Qamil Brovina, dhe Faik Pruthi. Ata mbesin në terrenin e Gjakovës dhe të nahijes për të mbajtur lidhje me bazat e tjera dhe t'i organizojnë partizanët e rinj.

Prania e aradhës në Gjakovë e rrethinë u përcoll me kujdes nga ana e pushtesit dhe bashkëpunëtorëve të tij. Ata shikonin në çdo mënyrë t'i binin në gjurma aradhës dhe ta likuidonin. Megjithatë pushtesit i shkoi përdore të fuste në aradhë bashkëpunëtorin e vet Rexhep Stubllen, prapëseprapë në saje të syçeltësisë së anëtarëve të partisë, SKOJ-it dhe të patriotëve të tjerë, Komiteti i Vendit të Gjakovës, sapo u informua për këtë, u zotua se do të marrë masa të nevojshme.

Aradha »Zejnel Hajdini« sipas planit të caktuar me përpikëri që më parë, e për t'u ruajtur që të mos zbulohet dhe të mos befasohet duke u rrethuar e sulmuar, ishte vazhdimisht në lëvizje. Kështu, luftëtarëve të kësaj aradhe iu desh mjaft mund e kohë për të përballuar një tempo lëvizjeje të tillë. Aradha ishte herë në njërin e herë në anën tjetër — posa krijoi bindje tek armiku se në kuadrin e vet ka shumë partizanë. Aradha pothuaj për çdo ditë kalonte nga 10 kilometra rrugë këmbë për t'u kthyer përsëri në fshat ose afër fshatit në të cilin kishte zënë vend.

Në fund të dhjetorit të vitit 1942 në aradhën »Zejnel Hajdini« bëhen ndërrime në kuadrin komandues. Komandant mbetet edhe më tutje Fadil Hoxha, komisar i aradhës u bë Elhami Nimani, zëvendës i komandantit Nijazi Spahiu, zëvendës i komisarit politik Dushko Tomoviç dhe intendant Idriz Bytyçi.

Në atë kohë aradha kishte tri togje: komandant i togut të parë ishte Idriz Bytyçi, komandant i togut të dytë — Beqir Ndou dhe komandant i togut të tretë — Dragutin Gjorgjeviq. Delegat politik në tog genë: Kurtesh Agushi, Mazllum Këpuska dhe Xhavit Brovina.

Gjersa aradha qëndronte në nahijen e Pejës dhe përpiqej të bjerë në kontakt me bazat partizane të Vitomiricës, në aradhë arriti Musa Zajmi dhe lajmëroi për vdekjen e Emin Durakut. Në atë moment në aradhë mbretëroi një heshtje. Partizanëve u shkuan lotët. Komandanti i aradhës shpejt e çmoi situatën dhe u drejtua partizanëve me disa fjalë, ku foli mbi jetën dhe veprimtarinë e Eminit dhe humbja e tij e madhe për Lëvizjen Nacionalçlirimtare.

Shtabi i aradhës partizane »Zejnel Hajdini« në letrën e dërguar familjes Emin Durakut i shprehi ngushllimet me këto fjalë:

»Lajmi i vdekjes së Eminit na ra si plumb në zemër të gjithë neve shokëve të tij partizanë, që po luftojmë për shelimin e popullit tonë.

Vrasja e tij nuk asht një humbje vetëm për ju, por asht një humbje e madhe për tanë popullin kosovar, e aq ma tepër për ne.

Por Emmini nuk ka vdekë, se emni i tij nuk do të harrohet e familja e juej duhet të jetë krenare se i dha këtij populli një luftarë të palodhshëm që shkriu çdo gja e deri jetën e vet për lirin e vendit të tij.

Ju humbët Eminin, por duhet ta dini se fituet me qinda djelmë të popullit tonë që frymëzohen në idealet e tij.

...

Jeni të sigurtë se fitimi ynë do të jetë i shpejtë e atëhere trupi i Eminit do të pushojë ma i qetë në tokën tonë, ku kamba fashiste nuk ka me shkelë ma...¹⁰

Me ftesën e Komitetit krahinor të PKJ të Kosovës e të Metohisë, aradha »Zejnel Hajdini« në gjysmën e dytë të dhjetorit kalon në terrenin e Kosovës në mënyrë që komandanti i saj Fadil Hoxha të mund të asistojë në Plenumin e Komitetit krahinor të PKJ, i cili duhej të mbahej në fshatin Vrellë edhe që aradha të operojë në Kosovë. Gjatë kalimit në terrenin e Kosovës aradha muar për detyrë që nga fshati Vitomiricë, afër Pejës, të marrë Stanko Buriqin, Voja Llakiçeviqin, Sillobodan Jovanoviqin, Zavrëzanin, skojist (i cili i mëshehu dhe i ruante) dhe Andro Vukmirovicqin dhe duke qar-kulluar nëpër fshatrat Lukë, Kodrali, Rrznia, Jabllanicë në drejtim të Podrimljes aradha arriti në terrenin e Kosovës dhe në fund të dhjetorit u vendos në fshatin Vrellë. Në fund të vitit aradha kishte afro 40 luftëtarë.

Në mbledhje të Plenumit të zgjëruar të Komitetit krahinor të PKJ të Kosovës e të Metohisë nga aradha muarën pjesë Fadil Hoxha dhe Elhami Nimani.

Në konkluzat e Plenumit formimi i aradhës vlerësohet pozitivisht. Në to, ndër të tjera, thuhet: »Me formimin e aradhës partizane »Zejnel Hajdini« u tregua dhe u argumentua haptaz se me luftë të drejtë partizane dhe me aktivitet më të gjërë politike do të mund t'i jipeshin grushta të rëndë armikut dhe të angazhohet një pjesë e madhe e masave të varfëra, sepse ato që tani po i shikojnë me simpati partizanët...

Në lidhje me ekzistimin e aradhave partizane lypset kushtuar kujdes që aradhat të plotësohen dhe të forcohen me forca të reja të freskëta dhe duhet mposhtur të gjitha pengesat që paraqiten në këtë drejtim.

Të ndihmohen njësitet partizane, të sprovohen në aksione dhe të ngritet niveli i tyre luftarak, e krahas me këtë të punohet në edukimin e tyre politik. Aksione mund të zhvillohen në vendet më të ndieshme të pushtuesit ku mund t'i jipen grushta të dukshëm, të rëndë«.¹¹

Pas konsultës para aradhës »Zejnel Hajdini« shtroheshin detyra dhe aksione të reja. Aksionet me karakter ushtarak lypset lidhur me aksionet me karakter politik, duhej dhënë lidhje të ngushtë me masat për hir të edukimit dhe përgatitjes së tyre për kryengritje të armatosur.

¹⁰ Letra e aradhës partizane »Zejnel Hajdini«, dt. KVGJ, 2.

¹¹ AEHK, dt. 118.

Atëbotë aradha ishte njësit vazhdimisht në lëvizje. Për shkak të sulmeve të parreshtura e të papritura të pushtuesit, aradha ndërronte vazhdimisht vendstrehimin e vet.

Më 31 dhjetor 1942 aradha »Zejnë Hajdini« u nis nga Vrella në drejtim të fshatit Suvi Do. Në këtë kohë aradhës iu bashkuan Toma Zhariq, Mihajlo Radulloviq dhe Vojin Lakčević. Aradha u nis natën e mëjgulla po rritej e dendësohej vazhdimisht, prandaj aradha për shkak të motit të këthillë të ligë udhëtoi bukur shumë prej Vrellës gjer në Suvi Do. Sipas planit të Shtabit aradha duhej të tërhiqej në Suvi Do, por për shkak se fshatarët u frikësuan, partizanët nuk u pranuan në këtë fshat për strehim e fjetje, prandaj Shtabi i aradhës vendosi të vazhdojë rrugën në Dobrotin. Pak para se të agonte dita aradha kaloi stacionin hekurudhor dhe rrugën të cilën e ruanin forcat italiane. Në Dobrotin në atë kohë ishte Zhi-vojin Çurçiq — Sërgja, anëtar i Komitetit të Vendit të PKJ për Prishtinë. Pasi pushoi aradha, të nesërmen u nis prej Dobrotinit në drejtim të Vërbicës dhe mbante lidhje me fshatin Zhegovc përmes Tahir Zhegovcit.

Aradha në atë kohë operonte nëpër Kosovë dhe vizitoi një sërë fshatrash. Duke qarkulluar nëpër këto fshatra, aradhës iu bashkua luftëtari Halil Fejzullahu nga Kamenica.

Partizanët e aradhës »Zejnë Hajdini« shikonin t'u afroreshin sa më tepër fshatarëve, t'i bindin për LNÇ. Ata përdornin forma të ndryshme për të rënë në kontakt me ta. Kështu, me një rast, partizanët e kësaj aradhe e shfrytëzuan varrosjen e një fshatari në fshatin Zborc. Në varrim shkuan Fadil Hoxha, Elhami Nimani dhe Alush Çorri. Pasi e çmuan situatën momentale, vendosën t'u mbanin një fjalim fshatarëve. U foli Fadil Hoxha. Ai i ftoi fshatarët që të përfshihen në Lëvizjen nacionalçlirimtare, ta ndihmonin dhe t'i dënonin tradhëtarët e popullit. Aradha u detyrua ta braktisë shpejt e shpejt fshatin, sepse po vinin forca të armikut dhe të tërhiqet në drejtim të pyjeve të Nerodimes me qëllim që në Jezerc ta sulmonin kompaninë e ushtarëve italianë që po prenin dru për garnizon në pyllin e atjeshëm.

Partizanët më 1 e 2 janar më kot po pritnin që të paraqiteshin italianët dhe t'i sulmonin, por ata nuk u dukën, sepse kren-tonin vitin e ri. Kjo shkaktoi mosdurim ke partizanët, prandaj e ndërruan drejtimin e qarkullimit dhe u nisën në drejtim të rrugës Prizren — Prishtinë. Duke zbritur nëpër malet e Crnalevës aradhës iu bashkua Nezir Rexhepi, i cili më së miri dinte rrugën më të shkurtër dhe më të sigurt për të arritur gjer në Crnalevë.

Para fillimit të aksionit, Shtabi i aradhës përgatiti planin e aksionit. Aradha u caktua në vendin e quajtur Puragat (Cërnalevë). Aradha u nda në tri grupe. Grupi i parë zuri pozitë në anën e majtë të rrugës, kurse ndërmjet këtyre dy grupeve ishin caktuar luftarët e grupit të tretë. Vëzhguesi ishte vendosur në vendin më të lartë që të mund të vështronte e të jipte shenjë për arritjen e armikut. Fadil Hoxha ndodhej në anën e majtë të rrugës, sepse pritej se kolona e armikut do të vijë prej Prishtinës në drejtim të Prizrenit.

Kjo nuk zgjati shumë. Vëzhguesi dha shenjë se po vinte kolona. Ishte ora rreth 16,30 minuta. Pikë së pari në pusi ra një veturë ushtarake në të cilën ishin karabinjerët Conapini Otornio dhe Capadoccio Valter dhe kapiteni i karabinjerisë nga Prizreni Lipari Conuelo dhe përcjellësi i tyre.

Në shenjë e komandantit u hap zjarr në drejtim të veturës. Vetura u përmbys. Kapiteni i karabinjerisë dhe karabinjerët bashkë me shoferin mbetën të vdekur në vend, kurse përcjellësi i tyre u plagos rëndë. Kjo skenë nuk zgjati shumë. Pas disa minutash u dëgjua ushtrimi e kolonës italiane prej 10 kamionash, e cila po vinte nga Ferizaji. Në atë kolonë ishin karabinjerët e seksionit të përzierë të divizionit KKMM «Puglia». Kamioni i parë e kaloi pusinë, por u bë shoshë dhe kështu u rrokullis në hendek. Kaluan kamionat e tjerë, njëri pas tjetrit. Italianët në fillim nuk mund të gjëndeshin, sepse nuk mund të supozonin se janë sulmuar nga partizanët. Gjaku rridhte rrëke nga kamionat e bërë shoshë. Kamionat e tjerë u ndalën dhe ushtarët iu përveshën luftës. U zhvillua luftë e rreptë mes ushtarëve italianë dhe partizanëve. Luftuan gjer në muzg të parë. Në këtë luftë të pabarartë u vra partizani Abdullah Shabani — Brica. Italianët humbën më se 20 ushtarë. U zunë pak armë. Ushtarët — karabinierët e vrarë u dërguan në Prizren, të cilët u varrosen të nesërmen në varreza të katolikëve në Prizren. Partizanët filluan të tërhiqeshin në mal nga ana e djathtë e rrugës. Kjo luftë e partizanëve, nëpër borë, të paarmatosur sa duhet, të rinj, të papërvojë, të veshur dobët, zbathur, por trima, u zhvillua më 2 janar 1943.

Në vendin ku kjo aradhë zhvilloi aksionin kundër fashistëve italianë është ngritur përmendore. Në përmendore janë skalitur fjalët:

*»Për rrënesën ma t'lume
Jetën dhash, këtu vlla,
Në ledinë atje një shok sërb ka
ra e përtej n'kodër një malazez
asht vra.
Shumë nesh ranë — gjaku
rrodh si krue, lirinë e vllaznimit
s'bashku t'u krijue.«*

Ky aksion e popullarizoi mjaft aradhën si fuqi të armatosur dhe të masat forcoi besimin në Lëvizjen nacionalçlirimtare.

»Pas këtij aksioni në popull zu të flitej me të madhe për aradhën, u krijuan madje dhe legjenda se komandanti i aradhës po shilon kalin e bardhë, se aradha është armatosur gjer në dhëmbë, se po bën aksione kudo që po e zë armikun«¹²

Ja si i këndoi populli heroizmit të aradhës partizane:

*N'Çërnalevë ka zonë pusi.
Vjen ushtria pa ja da,*

¹² AEHK, Stenogrami nr. 70, f. 75.

*Po bërtasin Talijan't;
»S'na lan vend kund partizan't!
S'na lan'vënd kund me pushue:
As n'kasarnë, as n'drum tuj shkue;
Tenk as topi hiq s'i pret;*

...

*Si n'Kosovë e Metohi,
Si gjithkund n'Jugosllavi,
Gjinden burra, djem të ri,
Qi s'pajtohen me robni —
Me zaptuesen Itali,
Me gjakpirsen Gjermani.
Partizan't jon'trima t'qitun,
Ni ushtri e kanë koritun.*

Aksioni i aradhës në Cërnalevë hy në radhën e aksioneve të mëdha dhe shumë të rëndësishme të armatosura në territorin e Kosovës e të Metohisë. Ky aksion u zhvillua në kohën kur në Kosovë e Metohi situata ishte shumë e vështirë, e reaksioni shumë i organizuar.

Ky aksion bëri që të shtohet besimi në forcat partizane e njëherit tregoi se armiku nuk është i pathyeshëm.

Pas aksionit të kryer, në prak të muzgut partizanët nga Cërnaleva arritën nëpër male duke udhëtuar gjithë natën të lodhur e të lagur në fshatin Softoviq dhe u vendosën në shtëpi të Millan Jelaçiqit, pastaj kaluan në Sojevë, Gërbollë dhe arrin në fshatin Vrellë. Në Sojevë mbeti Beqir Ndou, të cilit i ishin mbërdhirë këmbët. Në fshatin Vrellë, më së shumti u angazhuan për të mbajtur partizanët dhe u kujdesuan që ata të furnizohen me gjëra të nevojshme si Pavlija Pokushevska dhe Dunja Kilibarda etj.

Rrugën prej Cërnalevës gjer në Softoviq e bënë më shumë se 10 orë, ndonëse ky relacion në kushte normale mund të kalohet shumë më shpejt. Për aksionin e Cërnalevës u hap lajmi si rrufe në mbarë Kosovën dhe Metohinë.

Numri i partizanëve në aradhën »Zejnël Hajdini« po shtohej dita më ditë, por njëherit edhe numri i bazave për vendosjen e tyre ishte për çdo ditë gjithnjë e më i madh. Kjo bëri të mundur që të formohet edhe një aradhë.

Në dimër, në një acar të fortë, më 6 janar 1943 në malin Golesh aradha »Zejnël Hajdini« u nda në dy pjesë. Njëra pjesë duhej të operonte në terrenin e Karadakut, malit Shar dhe Ferizajt, e plotësuar me forca të reja — pjesëtarë të Lëvizjes nacionalçlirimtare — sërbë e shqiptarë nga territori i rrethit të Graçanicës dhe Nerodimles, e sidomos nga fshatrat Vrellë, Suvi Do, Liplan, Obiliq, Fushë — Kosovë, Rujicë e të tjera. Kjo aradhë duhej ta mbante emrin »Zejnël Hajdini«.

Aradha tjetër duhej të operonte në Metohi, por edhe në fshatrat e Kosovës dhe të Drenicës dhe përbëhej të shumtën nga shqip-

tarët. Brigada muar emrin »Emin Duraku«, sipas emrit të heroit të popullit Emin Duraku nga Gjakova, i cili u plagos për vdekje nga ana e armikut në mes Grackës së Vjetër, e i cili më 5 dhjetor 1942 vdiq në spital të Prizrenit. »

Komandant i aradhës »Zejnel Hajdini« u zgjodh Petar Brajeviq (ai që në malin Shar tuboi një grup partizanësh, e në Karadak duhej të lidhej me këtë aradhë dhe të merrte komandën). Komisar i aradhës ishte Njazi Spahiu, zëvendës — komandant Tomo Zhariq, kurse zëvendës — komisari Vojo Lakçeviq dhe shef i shtabit Kurtesh Agushi.

Komandant i aradhës »Emin Duraku« ishte Fadil Hoxha, komesar Qamil Brovina, zëvendëskomandant Idriz Bytyçi, zëvendës — komisari Musa Zajmi.

Para luftëtarëve të njëjës dhe tjetrës aradhë shtroheshin detyra të reja e të rënda.

Aradha »Emin Duraku« mori për detyrë të manevrojë në Metohi, të zhvillojë aksione, zhvillojë luftë kundër pushtuesit dhe bashkëpunëtorëve të tij, të mbajë konferenca politike në rrethinën e Prizrenit, Rahovecit e Gjakovës. Kur aradha u nis nga Metohia, ajo mbajti konferencën e vet të parë në fshatin Arilaç.

Një nga detyrat e para, shumë të vështira, që mori mbi vete aradha me rastin e formimit, ishte të shkojë në drejtim të Rozhajës, të vihet atje në anën e atyre njerëzve që vuanin nga çetnikët e Pavle Gjurishiqit. Në atë kohë çetnikët bënin masakrime të mëdha mbi popullsinë e pafajshme muslimane në Bihor. Pushtuesi e shfrytëzoi këtë masakër që në tërë Kosovën ta shpjegojë këtë, sidomos midis shqiptarëve, si vepër të serbëve, pa marrë parasysh a ishin partizanë apo çetnikë ata që sulmonin shqiptarët (italianët i konsideronin shqiptarë muslimanët e Bihorit). Qëllimi i këtij agjitacioni të pushtuesit ishte krijimi i një jazi sa më të madh midis popullsisë së Kosovës. Në Rozhajë u therrën nga ana e çetnikëve disa mijëra vetë. Që të mund të mobilizojë një numër sa më të madh vullnetarësh, që të krijojë një jaz sa më të madh midis serbëve e shqiptarëve, pushtuesi hodhi me forcë të ikurit e dëmtuar që t'i flasin nëpër tubime popullit të Kosovës për dhunë që gjoja bënë partizanët mbi popullsinë e Rozhajës. Armiku kishte për qëllim t'i njëjlos partizanët si terroristë duke ua përshkruar për të tyre masakrën që bënë çetnikët në Bihor.

Aradha »Zejnel Hajdini« u plotësua në janar të vitit 1943 me luftëtarë të rinjë, të papërvojë.

Aradha, para përpjekjes së vet që të vihet në kontakt me grupin e partizanëve të Sharrit, mbajti konferenca në fshatrat e Kosovës, përgatiti baza për luftëtarët, përgatiti armë, ushqim, veshmbathje e të tjera, sepse priteshin detyra të reja e të rënda gjatë dimrit.

Aradha »Zejnel Hajdini« mori për detyrë të veprojë në luginën e Moravës së Epërme, grykën e Kaçanikut dhe në rrethinë. Që aradha të mund të bashkohet më lehtë me grupin e partizanëve, që gjëndej në Sharr nën komandën e Petar Brajeviqit, ajo u nda në dy grupe. Grupi i parë prej 30 partizanësh, nën udhëheqjen e zëvendës-komandantit Toma Zhariq — Ajrullahut, u nis prej Vre-

lle, Suho Do, Tankosiqi dhe në fshatin Gërmovë aradha pushoi dy ditë, e pastaj vazhdoi rrugën nga Pozharani. Nëpër furtunë të fuqishme, me luftëtarë të rinj e të papërvojë, grupi i parë i partizanëve të aradhës »Zejnel Hajdini« i afrohej ngadalë kufirit italo-angullgar dhe u ndal afër fshatit Biqë. Partizanët dërguan korierët për të vendosur lidhje me Petar Brajeviqin. Duke pritur lidhjen, grupi i partizanëve u sulmua nga patrulla e ushtrisë fashiste bullgare, sepse për shkak të pakujdesisë dhe mosvigjilencës u diktuuan. Në këtë sulm u vranë: Rade Bërklaj nga Suho Do, Ranko Mariqiq nga Fushë-Kosova, Kërsto Kovaçeviq nga Fushë-Kosova, Milenko Vujaçiq nga Vrella dhe Jovo Peshiq nga Tankosiqi.¹³ Në mesin e partizanëve u krijua një lloj paniku, ata nuk ditën të gjenden, u shpartalluan duke mos i bërë kurrfarë rezistence armikut. Kështu të frikësuar, të demoralizuar, shumica e luftëtarëve u kthyen në fshatin Gërbolë, e gjithashtu edhe Pojatishtë, Tankosiq, Softoviq, Pozharan dhe fshatrat e tjera të afërme. Një numër luftëtarësh partizanë kërkoi të kthehet nëpër shtëpia, kurse pjesa tjetër nga fundi i janarit bëri përpjekjen e dytë që me grupin e partizanëve të udhëhequr nga Aleksandar Urdarevski dhe Vojislav Llakçeviq të kalojnë kufirin bullgar e të vihen në kontakt me Petar Brajeviqin në Sharr, por as këtij grupi nuk i shkoi përdore të arrijë më larg fshatit Staro Gracka, sepse këtu u sulmuan dhe u shpartalluan. Në këtë sulm afër Staro Grackës u vranë Aleksandar Urdarevski, Vojo Llakçeviq, Nedelko Miliçeviq, Ilija Mirkoviq, nga Staro Gracka, Sibin Damjanoviq nga Rujica, Vidosav Aksiq nga Lipjani, Gjorgje Mikiq nga Koshara dhe një maqedon nga Kumanova.¹⁴ Partizanët e mbetur gjallë u shpërndanë nëpër fshatrat e afërme, por armiku përcillte çdo qarkullim të partizanëve, kështu që diktoi arritjen e dy partizanëve në fshatin Gërbolë. Për këtë u informua policia, e cila arriti prej Babushit në drejtim të fshatit Gërbolë. Fshati Gërbolë u rrethua më 30 janar 1943. Filluan torturat dhe rrahjet. Italianët kërkonin armë në fshat. Ata i mblodhën disa fshatarë para shkollës dhe të lidhur i dërguan në Radevë në zyrën e komunës.

Me këto sulme, nga fundi i janarit, aradha »Zejnel Hajdini« u shpërnda plotësisht dhe pushoi të veprojë si aradhë.

Aradha »Zejnel Hajdini« nuk pati jetë të gjatë. Veproi vetëm katër muaj, por gjatë kësaj kohe të shkurtër ndërmori një sërë aksionesh të rëndësishme pikërisht në kohën kur kushtet për luftë dhe ekzistencë të aradhës ishin të vështira, për shkak të ditëve të dimrit dhe aktivitetit të reaksionit, që në çfardo mënyre dëshironte ta shkatërrojë Lëvizjen nacionalçlirimtare në Kosovë e Metohi.

Duke folur mbi kushtet në të cilat luftoi aradha »Zejnel Hajdini«, Fadil Hoxha thotë: »Aradha »Zejnel Hajdini« pati 30 — 40, luftarë, e nëpër të kaluan afër 150 vetë. Vinin, sëmuheshin, lëshonin aradhën e të tjera. Kjo ishte aradhë e lëvizshme, sonte këtu e nesër 20 kilometra më tutje, pasnesër edhe 20 kilometra të tjera. Të jeshë në aradhë ishte gjë shumë e vështirë.

¹³ AEHK, *Stenogrami nr. 74*, f. 237, dhe 230.

¹⁴ AEHK, *Stenogrami 74*, f. 36, dhe nr. 240 e 188.

Një numër shokësh pati kondicion t'i bëjë ballë kësaj tempoje. Një numër luftëtarësh u sëmua nga mushkëritë, veshkët dhe nyjeve të eshtrave. Ngjante që aradha të hyjë në fshat, të mbajë konferenca, bënte ndonjë aksion dhe vazhonte rrugën mëtutje.¹⁵

Për shkak të situatës së këtillë një numër partizanësh u demoralizuan, kështuqë një numër i vogël sish dezertuan. Lypset përmendur se në mesin e tyre nuk ka pasur anëtarë të PKJ dhe të SKOJ-it. Partizanët gjetën fuqi për të përballuar të gjitha vështirësitë e luftës partizane. Luftëtarët e kësaj aradhe luftuan në kushte të vështira, ngado që kanë qarkulluar nëpër fshatra të Kosovës, prej Kumanovës gjer në Pejë dhe prej Golakut gjer në Malësi. Aradha deri kur u nda në dy aradha kur nuk është befasuar dhe sulmuar. Gjithmonë i ka shkuar përdore të ruhet prej sulmeve të papritura nga forcat e armikut. Përpiqej ta befasojë armikun në çdo aksion.

Aradha operoi në kohën kur forcat e pushtuesit dhe kuislinge ishin të forta dhe kur në territorin e Kosovës, gjegjësisht në jug të Jugosllavisë s'kishte partizanë, pos aradhës së Vranjës.

Aradha »Zejnel Hajdini« ka luajtur rol të madh e të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të Luftës nacionalçlirimtare në Kosovë e Metohi. Rëndësi të posaçme ka edhe fakti se mu nëpër këtë aradhë janë formuar, aftësuar dhe ngritur politikisht një numër i madh partizanësh të spikatur.

Karakteristikë kryesore e aradhës kanë qenë aksionet e vogla diverzante, por njëherit edhe përleshjet e rëndësishme luftarake, pengimi i kohëpaskohshëm i qarkullimit normal në komunikacionin publik në rrugët e rëndësishme.

»Aradha ka ushtuar ndikim të madh, si te shqiptarët, ashtu edhe te sërëbët, sepse në këtë mënyrë e panë se shqiptarët po luftojnë kundër pushtuesit e kjo kishte rëndësi të madhe për marrëdhënje ndërnacionale në këtë anë. Aksionet që i zhvilloi aradha ishin të suksesshme dhe shumë të rëndësishme për popullarizimin e luftës nacionalçlirimtare në Kosovë e Metohi dhe përgjithësisht në Jugosllavi. Aradha »Zejnel Hajdini« tregoi haptazi se madje edhe këtu ku fashizmi mendonte se do të jetë kjo zonë e qetë, pa se për pushtuesin nuk do të ketë qetësi askund.«¹⁶

Situata politike në atë kohë kur formohen dy aradha — »Zejnel Hajdini« dhe »Emin Duraku« — dhe kur pushoi të vepronte aradha »Zejnel Hajdini« ishte shumë e vështirë. Reaksioni po marshonte në mënyrë shumë të organizuar në mbarë krahinën e Kosovës dhe të Metohisë. U organizuan njësite të veçanta të armatatura kundër Lëvizjes nacionalçlirimtare. U formuan aradha fluturake që sulmonin sistematikisht aradhat partizane dhe vendstrehimet e tyre. Arësyeja e shpërndarjes, në të vërtetë e ndarjes të aradhës »Zejnel Hajdini« është se në një situatë të këtillë të vështirë u plotësua me njerëz të rinj të papërvojë dhe u thye mu atëherë kur lejoi të befasohej dhe të sulmohej. Por vetë fakti se aradha qëndroi dhe operoi me sukses katër muaj tregon se ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm.

¹⁵ AEHK, *Stenogram* 74, 227.

¹⁶ AEHK, *Stenogram* 70.

SHTABI I ARADHËS »ZEJNEL HAJDINI«

Shtator 1942

Komandant Xheladin Kurbaliu, zëvendës-komesar Pera Karaxhiq,
Komesar politik Fadil Hoxha, zëvendës-komesari pol. Kurtesh Agushi, intedant Nijazi Spahiu.

Tetor 1942 — në kohën e akcionit në minierën Lojane

Komandant Zhivojin Nikoliq-Bërka, zëvendës-komandanti Xheladin Kurbaliu, komesar politik Fadil Hoxha, zëvendës — komesari pol. Slobodan Cekiq, intedant Nijazi Spahiu.

Gjysma e nëndorit 1942

Komadant Fadil Hoxha zëvendës-komandanti Nijazi Spahiu. Kryesi i detyrës së komisarit politik deri sa aradha arrin në Gjakovë Mazllum Këpuska, zëvendës-kom. polit. Dushko Tomoviq.

Dhjetor 1942

Komandant Fadil Hoxha, zëvendës-komand. Nijazi Spahiu Komesar politik Elhami Nimani, zëvendës-kom. polit. Dushko Tomoviq

Komandant i togut të parë Idriz Bytyçi, delegat politik Kurtesh Agushi, Komandant i togut të dytë Beqir Ndou, delegat politik Mazllum Këpuska e më vonë Gani Çavdarbasha.

Komandant i togut të tretë Dragutin Gjorgjeviq, del. pol. Xhavit Brovina

Shtabi i aradhës »Zejnel Hajdini« pas 6 janarit 1943,

Komandant Petar Brajeviq, zëvendës-komand. Toma Zhariq, Komesar Nijazi Spahiu, zëvendës-komesar politik Voja Lakçeviq, Shef i Shtabit Kurtesh Agushi.

LISTA JO E PLOTË E LUFTËTARËVE TË ARADHËS »ZEJNEL HAJDINI«

1. Xheladin Myftari Kurbaliu, Kurbali, Gilan, vranë
2. Fadil Hoxha-Blini-Dyl Tahiri, Gjakovë, Beograd
3. Kurtesh Agushi, Gilan, penzionist në Shkup
4. Pero Karaxhiq — Muja, Prishtinë, penzionist në Beograd
5. Nijazi Spahiu — Babaxhan, Lumë, penzionist në Valevë
6. Faik Xhema Kashtanjeva, Kashtanjevë, punëtor në Ferizaj
7. Asllan Biqevci
8. Riza Selim Presheva
9. Veli Fetahu, Kurbali
10. Arif Misini, Trnavë
11. Elmaz Hasani
12. Ejup Tërpeza, Tërpezë, vranë
13. Stanijan Dimitrijeviq-Shefqet, Tërpezë, Banja e Klllokotit
14. Gojkoviq Dimitrije-Hamit, Tërpezë, penzionist në Viti
15. Gani Çavdarbasha — Deli, Prizren, vranë
16. Dimitrije Stojkoviq, Novo Selo
17. Mazllum Këpuska, Gjakovë, vranë
18. Idriz Bytyqi, Gjakovë, vranë
19. Meto Bajraktari, Prishtinë, vranë
20. Hamzë Krasniqi, Doganoviq, penzionist në Kaçanik
21. Viktor Gulija — Isok, Shkup, penzionist në Shkup
22. Dushko Tomoviq — Ivo, K. Mitrovicë, Beograd
23. Elhami Nimani — Leka, Gjakovë, Beograd
24. Qamil Brovina — Bujku, Gjakovë, Prishtinë
25. Xhavit Brovina — Piloti, Gjakovë, Prishtinë
26. Beqir Ndou — Betoni, Mirtur, Shqipëri
27. Musa Zajmi, Gjakovë, vranë
28. Nexhmedin Nixha, Gjakovë, vranë
29. Dragutin Gjorgjeviq, Ali Llukaci, Gjakovë, gjeneral në penz. Bgd.

30. Metush Grezda, Gjakovë, deputet i dhomës republikane, Gjakovë
31. Xheladin Nixha, Gjakovë, Gjakovë
32. Mazllum Baraku, Gjakovë, Gjakovë
33. Pavle Miranoviq-Kadri, Ratkocer, penzionist në Ratkocer.
34. Abdullah Shabani — Brica, Mitrovicë, vrarë
35. Halil Fejzullahu, Kamencirë, Kamenicë
36. Alush Pasuli — Çorri, Prizren, penzionist në Prizren
37. Nisim Starova — Toska, Shqipëri
38. Nezir Rexhepi, Grejçevc, vrarë
39. Jovo Novakoviq-Vejseli, Novo Rujice, penzionist në Petrovac na Mlavi
40. Asllan Sojeva, Sojevë, Ferizaj
41. Faik Pruthi, Gjakovë, punëtor, Mitrovicë.
42. Reshat Xhaferi, Shkup, vrarë pasë luftës si pilot
43. Osman Jusufi, Prishtinë, deputet i dhomës republikane, Prishtinë
44. Tafa Kamogllava, Kamogllavë, punëtor në Shkup
45. Stanoje Stanojeviq, Gjakovë
46. Toma Zhariq — Hajrullah, penzionist në Beograd
47. Sinan Hasani, Pozharan, Ambasadori i RFSJ në Danimarkë
48. Mihajllo Radulloviq-Zejnel, Arilaq

Pasi ndahet në dy aradha, aradha »Zejnel Hajdini« plotësohet me luftëtarë të rinj:

49. Vojislav Lakqeviq, Ulcin — Gjakovë, vrarë
50. Rade Brklaq, Suhi Doll, vrarë
51. Ranko Mariçiq, Fushë — Kosovë, vrarë
52. Krsto Kovaçeviq, Fushë — Kosovë, vrarë
53. Krsto Krainoviq, Fushë — Kosovë, vrarë
54. Aleksandar Urdarevski, Maqedoni, vrarë
55. Nedeljko Miliçeviq, Staro Grasko, vrarë
56. Milenko Vujaçiq, Vrellë, vrarë
57. Ilija Mirkoviq, Staro Gracko, vrarë
58. Sibin Damjanoviq, Rujicë, vrarë
59. Vidosav Aksiq, Liplan, vrarë
60. Rade Brulac, Suví Do
61. Dushan Mitroviq, Suví Do
62. Ilija Mirkoviq, Novo Rujice
63. Ljuba Stankoviq, Novo Rujice
64. Dragi Filipoviq, Prishtinë, Beograd
65. Veljko Mirjaçiq, Vrellë
66. Mitar Mirjaçiq, Vrellë
67. Gjoko Shurbatoviq, Vrellë

Vahide Hoxha

LE CONTINGENT PARTISAN »ZEJNEL HAJDINI«

R é s u m é

Le premier contingent partisan albanais du Kossovo était le contingent partisan »Zejnel Hajdini« qui fut constitué en septembre de l'année 1942.

Le contingent »Zejnel Hajdini« a joué un rôle important dans le développement futur de la lutte de libération nationale du Kossovo-Métohie.

Son importance est particulièrement significative aussi du fait que dans ce bataillon ont été formés politiquement de nombreux partisans célèbres.

Le contingent en question s'est distingué par des opérations de diversions, ainsi que par d'importants combats et par l'interruption temporaire des communications publiques dans les voies principales.